Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

RREGULLORE (ZKM) NR. 16/2026 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS TË AGJENCISË SË METROLOGJISË SË KOSOVËS[1]

[1]Rregullore (ZKM) Nr. 16/2026 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Agjencisë së Metrologjisë së Kosovë, është miratuar me Vendimin Nr.090/2026, të datës 28/10/2026 nga Kryeministri i Republikës së Kosovës.

Kryeministri i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 94 paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 paragrafi 4 nën paragrafi 4.5 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 5 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 06/L-037 për Metrologji, nenit 5 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-029 për Punimet nga Metalet e Çmuara, nenit 28 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, nenit 9 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr. 17/2024 për Punën e Qeverisë së Republikës së Kosovës, si dhe nenit 9 paragrafi 7 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Bashkëpunimin në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura,

Miraton:

RREGULLORE (ZKM) NR. 16/2026 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS TË AGJENCISË SË METROLOGJISË SË KOSOVËS

Neni 1
Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Agjencisë së Metrologjisë të Kosovës.

Neni 2
Fushëveprimi

Kjo Rregullore zbatohet për Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, ku kompetencat për fushën e metrologjisë përcaktohen me Ligjin përkatës për Metrologji, si dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 3
Përkufizimet

Termat e përdoruara në këtë rregullore kanë kuptimin e njëjtë me terminologjinë e përdorur në ligjin përkatës për metrologji dhe ligjin përkatës për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura.

Neni 4
Misioni i Agjencisë së Metrologjisë së Kosovës

Misioni i Agjencisë së Metrologjisë së Kosovës (më tutje: AMK) është rregullimi i sistemit të njësive matëse, etalonëve shtetëror për matje, mbrojtjen e konsumatorëve nëpërmjet organizimit të kontrollit të mjeteve matës në fushat e transaksioneve zyrtare dhe tregtare, mbrojtjen e shëndetit, mjedisit dhe sigurisë teknike, kontrollin sasior të para paketimeve si dhe shishet si enë matëse, ofrimin e shërbimeve të kalibrimit prodhuesve dhe përdoruesve të mjeteve matëse, me qëllim të sigurimit të besueshmërisë së matjeve dhe rritjes së konkurrueshmërisë në tregun e brendshëm dhe të jashtëm.

Neni 5
Struktura Organizative e AMK

1.Struktura Organizative e Agjencisë së Metrologjisë së Kosovës është si vijon:
- 1.1. Zyra e Drejtorit Ekzekutiv;
- 1.2. Departamentet; dhe
- 1.3. Divizionet.

2. Numri i të punësuarve në Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës është dyzet e nëntë (49).

Neni 6
Zyra e Drejtorit Ekzekutiv

1. Zyra e Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë së Metrologjisë së Kosovës, përbëhet nga:
   - 1.1.Drejtori Ekzekutiv;
   - 1.2. Asistent Administrativ;
   - 1.3. Zyrtar i Bazës së të Dhënave;
   - 1.4. Zyrtar i Lartë i Menaxhimit të Sistemit të Cilësisë.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit Ekzekutiv përcaktohen sipas ligjit përkatës për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore, Ligjin për Zyrtarët Publik, Ligjin përkatës për Metrologji si dhe me legjislacionin tjetër në fuqi.

3. Detyrat dhe përgjegjësitë e nëpunësve civil të Zyrës së Drejtorit Ekzekutiv, përcaktohen në përputhje me legjislacionin për zyrtarë publik dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

4. Numri i të punësuarve në Zyrën e Drejtorit Ekzekutiv është katër (4).

Neni 7
Departamentet dhe Divizionet e AMK

1. Në kuadër të AMK funksionojnë departamentet dhe divizionet vijuese:
   1.1.Departamenti i Metrologjisë Shkencore dhe Industriale:
      1.1.1. Divizioni i Masës dhe Matjeve Dimensionale;
      1.1.2. Divizioni i Forcës dhe Presionit;
      1.1.3. Divizioni i Vëllimit dhe Rrjedhjes;
      1.1.4. Divizioni i Madhësive Elektrike dhe Termometrisë.

   1.2. Departamenti i Metrologjisë Ligjore:
      1.2.1. Divizioni i Madhësive Mekanike;
      1.2.2. Divizioni i Madhësive Elektrike.

   1.3.Departamenti i punimeve nga Metalet e Çmuara.
      1.3.1. Divizioni për Kontrollim të Cilësisë së Arit dhe Platinës;
      1.3.2. Divizioni për Kontrollim të Cilësisë së Argjendit dhe Palladiumit.

Neni 8
Departamenti i Metrologjisë Shkencore dhe Industriale

1. Departamenti i Metrologjisë Shkencore dhe Industriale ka për qëllim zhvillimin dhe mirëmbajtjen e etalonëve shtetëror të matjes dhe materialeve referente, për të ofruar gjurmueshmëri deri te Sistemi Ndërkombëtar i Njësive (SI), respektivisht për të dëshmuar pajtueshmëri dhe pranim ndërkombëtar, ngritjen e Sistemit të Cilësisë në laboratorët kalibrues, ofrimin e mbështetjes teknike për autoritetin shtetëror të akreditimit.

2.Detyrat dhe Përgjegjësitë e Departamentit të Metrologjisë Shkencore janë:
   2.1. Mirëmbajtja e vazhdueshme e etalonëve shtetërorë të matjes të Republikës së Kosovës, me qëllim të sigurimit të matjeve të sakta gjatë kalibrimeve për nevojat e metrologjisë shkencore, industriale dhe ligjore;
   2.2. Mbikëqyrja e gjurmueshmërisë matëse në Republikën e Kosovës deri te sistemi ndërkombëtar i njësive (SI) të njësive matëse, në fushën e metrologjisë shkencore dhe industriale;
   2.3. Përgatitja dhe hartimi i dokumentacionit që lidhet me etalonët shtetërorë të matjes të Republikës së Kosovës, metodat dhe procedurat e kalibrimit, vlerësimin e rezultateve të matjeve gjatë kalibrimit dhe ndër-krahasimeve laboratorike, protokollet e matjes, certifikatat, si dhe administrimi dhe mirëmbajtja e bazës së të dhënave të etalonëve të AMK;
   2.4. Mbikëqyrja e shfrytëzimit të pajisjeve, etalonëve dhe materialeve referente, si dhe bashkëpunimi me laboratorët e autorizuar;
   2.5. Mbikëqyrja e veprimtarive hulumtuese dhe zhvillimore, si dhe propozimi i prioriteteve për

realizimin e projekteve zhvillimore në fushën e metrologjisë shkencore dhe industriale;

2.6. Hartimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të strategjisë zhvillimore për metrologjinë shkencore dhe industriale, si dhe përpilimi i analizave lidhur me cilësinë në këtë fushë;

2.7. Zbatimi dhe mbikëqyrja e sistemit të cilësisë në përputhje me kërkesat e standardit ISO/IEC 17025 për shërbimet e kalibrimit, në bashkëpunim me Zyrtarin e Lartë të Menaxhimit të Sistemit të Cilësisë.

3. Drejtori i Departamentit të Metrologjisë Shkencore dhe Industriale raporton tek Drejtori Ekzekutiv i AMK.

4. Numri i të punësuarve në këtë departament është tetëmbëdhjetë (18).

Neni 9
Divizioni i Masës dhe Matjeve Dimensionale

1. Divizioni i Masës dhe Matjeve Dimensionale ka për qëllim të sigurojë gjurmueshmërinë, saktësinë dhe besueshmërinë e matjeve në fushat e masës, gjatësisë dhe matjeve dimensionale në Republikën e Kosovës, përmes zhvillimit, mirëmbajtjes dhe kalibrimit të etalonëve shtetërorë, si dhe përmes garantimit të përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare, në veçanti ISO/IEC 17025. Divizioni kontribuon në përmirësimin e infrastrukturës metrologjike kombëtare përmes ofrimit të shërbimeve profesionale të kalibrimit, organizimit të trajnimeve dhe pjesëmarrjes aktive në rrjetet metrologjike evropiane dhe ndërkombëtare.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të Masës dhe Matjeve Dimensionale janë:

2.1. Përpilimi dhe plotësimi i formës për deklarimin e aftësive matëse dhe kalibruese, njohjen dhe përdorimin e gjurmueshmërisë të etalonëve shtetëror të matjes së madhësive mekanike në fushën e masës, gjatësisë dhe matjeve dimensionale të specifikuara, për të cilat është përgjegjës divizioni;

2.2. Përgatitja dhe rishikimi i procedurave, instruksioneve dhe dokumenteve e nevojshme të këtij divizioni;

2.3. Hartimi dhe plotësimi i kërkesave për përgatitjen dhe kalibrimin e etalonëve referent të përdorura në rangun e specifikuar të matjeve në Republikën e Kosovës;

2.4 Sigurimi i një proces efektiv të gjurmueshmërisë, sistemit të planifikimit, zhvillimit dhe ruajtjes së etalonëve shtetëror të matjes së madhësive të specifikuara fizike, si dhe transmetimi e vlerave të tyre, deri në etalonët e nivelit më të ulët ose të shprehura në formë të rezultateve të matjes, në certifikatë kalibruese;

2.5. Zhvillimi dhe e mirëmbajtja e sistemit të menaxhimit të cilësisë të laboratorëve kalibrues në përputhje me kërkesat e standardit ISO/IEC 17025 dhe rekomandimet e specialisti të menaxhimit të sistemit të cilësisë;

2.6 Lëshimi i certifikatave të kalibrimit për mjetet matëse nga divizioni i lartë cekur sipas hierarkisë së gjurmueshmërisë dhe kërkesave që dalin nga menaxhimi i sistemit të cilësisë të AMK;

2.7.Organizimi i trajnimeve të vazhdueshme për stafin e laboratorëve të kalibrimit, kryesisht në metrologjinë shkencore dhe industriale, dhe në vlerësimin e metodave kalibruese të fushave të madhësive për të cilat divizioni është përgjegjës;

2.8. Organizimi i krahasimeve ndër laboratorike me laboratorët vendorë të fushave të ngjashme, për vlerësimin e procedurave kalibruese, sipas kërkesave themelore nga sistemi i cilësisë së AMK;

2.9.Pjesëmarrja në aktivitetet përkatëse të Komiteteve Teknike EURAMET, duke përfshirë krahasimet ndër laboratorike bilaterale dhe multilaterale në këtë divizion.

3. Udhëheqësi i Divizionit të Masës dhe Matjeve Dimensionale raporton tek Drejtori i Departamentit të Metrologjisë Shkencore dhe Industriale.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Masë dhe Matje Dimensionale është katër (4).

Neni 10
Divizioni i Forcës dhe Presionit

1. Divizioni i Forcës dhe Presionit ka për qëllim të sigurojë gjurmueshmërinë, saktësinë dhe besueshmërinë e matjeve në fushat e forcës dhe presionit në Republikën e Kosovës, përmes zhvillimit, mirëmbajtjes dhe kalibrimit të etalonëve shtetërorë, si dhe përmes garantimit të përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare, në veçanti ISO/IEC 17025. Divizioni kontribuon në përmirësimin e infrastrukturës metrologjike kombëtare përmes ofrimit të shërbimeve profesionale të kalibrimit, organizimit të trajnimeve dhe pjesëmarrjes në rrjetet metrologjike evropiane dhe ndërkombëtare.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të Forcës dhe Presionit janë:

2.1. Përpilimi dhe plotësimi i formave për deklarimin e aftësive matëse dhe kalibruese, njohjen dhe përdorimin e gjurmueshmërisë të etalonëve shtetëror të matjes së madhësive mekanike në fushën e forcës dhe presionit të specifikuara për të cilat është përgjegjës divizioni;

2.2.Përgatitja dhe rishikimi i procedurave, instruksioneve dhe dokumenteve te nevojshme të këtij divizioni;

2.3. Përpilimi dhe plotësimi i kërkesave për përgatitjen dhe kalibrimin e etalonëve referent të përdorura në rangun e specifikuar të matjeve në Republikën e Kosovës;

2.4. Sigurimi i një procesi efektiv të gjurmueshmërisë, sistemit të planifikimit, zhvillimit dhe ruajtjes së etalonëve shtetëror të matjes së madhësive të specifikuara fizike, si dhe transmetimin e vlerave të tyre, deri në etalonët e nivelit më të ulët ose të shprehura në formë të rezultateve të matjes, në certifikatë kalibruese;

2.5. Zhvillimi dhe mirëmbajtja e sistemit te menaxhimit të cilësisë të laboratorëve kalibrues në

divizionin e forcës dhe presionit në përputhje me kërkesat e standardit ISO/IEC 17025 dhe rekomandimet e specialistit të menaxhimit të sistemit të cilësisë;

2.6.Lëshimi i certifikatave të kalibrimit për mjetet matëse nga Divizioni i Forcës dhe Presionit, sipas hierarkisë së gjurmueshmërisë dhe kërkesave që dalin nga menaxhimi i sistemit të cilësisë të AMK;

2.7.Organizimi i trajnimeve të vazhdueshme për stafin e laboratorëve të kalibrimit, kryesisht në metrologjinë shkencore dhe industriale dhe në vlerësimin e metodave kalibruese të fushave të madhësive për të cilat divizioni është përgjegjës;

2.8. Organizimi i ndër-krahasimeve laboratorike me laboratorët vendor të fushave të ngjashme për vlerësimin e procedurave kalibruese, sipas kërkesave themelore nga sistemi i cilësisë së AMK;

2.9.Pjesëmarrja në aktivitetet përkatëse të Komiteteve Teknike EURAMET, duke përfshirë krahasimet ndër-laboratorike bilaterale dhe multilaterale në këtë divizion.

3. Udhëheqësi i Divizionit të Forcës dhe Presionit raporton tek Drejtori i Departamentit të Metrologjisë Shkencore dhe Industriale.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin e Forcës dhe Presionit është katër (4).

Neni 11
Divizioni i Vëllimit dhe Rrjedhjes

1.Divizioni i Vëllimit dhe Rrjedhjes ka për qëllim të sigurojë gjurmueshmërinë, saktësinë dhe besueshmërinë e matjeve në fushat e vëllimit dhe rrjedhjes në Republikën e Kosovës, përmes zhvillimit, mirëmbajtjes dhe kalibrimit të etalonëve shtetërorë, si dhe përmes garantimit të përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare, në veçanti ISO/IEC 17025. Divizioni kontribuon në përmirësimin e infrastrukturës metrologjike kombëtare përmes ofrimit të shërbimeve profesionale të kalibrimit, organizimit të trajnimeve dhe pjesëmarrjes në rrjetet metrologjike evropiane dhe ndërkombëtare.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të Vëllimit dhe Rrjedhjes janë:

2.1.Përpilimi dhe plotësimi i formave për deklarimin e aftësive matëse dhe kalibruese, njohjen dhe përdorimin e gjurmueshmërisë së etalonëve shtetëror të matjes së madhësive mekanike në fushën e vëllimit dhe rrjedhjes të specifikuara për të cilat është përgjegjës divizioni;

2.2.Përgatitja dhe rishikimi i procedurave, instruksioneve dhe dokumenteve te nevojshme të divizioni;

2.3.Përpilimi dhe plotësimi i kërkesave për përgatitjen dhe kalibrimin e etalonëve referent të përdorura në rangun e specifikuar të matjeve në Republikën e Kosovës;

2.4. Sigurimi i një procesi efektiv të gjurmueshmërisë, sistemit të planifikimit, zhvillimit dhe ruajtjes së etalonëve shtetëror të matjes së madhësive të specifikuara fizike, si dhe transmetimin e vlerave të tyre, deri në etalonët e nivelit më të ulët ose të shprehura në formë të rezultateve të matjes, në certifikatë kalibruese;

2.5. Zhvillimi dhe e mirëmbajtja e sistemit te menaxhimin të cilësisë të laboratorëve kalibrues në

divizionin e vëllimit dhe rrjedhjes në përputhje me kërkesat e standardit ISO/IEC 17025 dhe rekomandimet e specialistit të menaxhimit të sistemit të cilësisë;

2.6. Lëshimi i certifikatave të kalibrimit për mjetet matëse nga divizionin e vëllimit dhe rrjedhjes sipas hierarkisë së gjurmueshmërisë dhe kërkesave që dalin nga menaxhimi i sistemit të cilësisë të AMK;

2.7. Organizimi i trajnimeve të vazhdueshme për stafin e tij të laboratorëve të kalibrimit, kryesisht në metrologjinë shkencore dhe industriale, dhe në vlerësimin e metodave kalibruese të fushave të madhësive për të cilat divizioni është përgjegjës;

2.8. Organizimi i ndër-krahasimeve laboratorike me laboratorët vendor të fushave të ngjashme, për vlerësimin e procedurave kalibruese, sipas kërkesave themelore nga sistemi i cilësisë së AMK;

2.9. Pjesëmarrja në aktivitetet përkatëse të Komiteteve Teknike EURAMET, duke përfshirë krahasimet ndër-laboratorike bilaterale dhe multilaterale në këtë divizion.

3. Udhëheqësi i Divizionit të Vëllimit dhe Rrjedhjes raporton tek Drejtori i Departamentit të Metrologjisë Shkencore dhe Industriale.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin e Vëllimit dhe Rrjedhjes është katër (4).

Neni 12
Divizioni i Madhësive Elektrike dhe Termometrisë

1. Divizioni i Madhësive Elektrike dhe Termometrisë ka për qëllim të sigurojë gjurmueshmërinë, saktësinë dhe besueshmërinë e matjeve në fushat e elektrikes, termometrisë dhe lagështisë relative zhvillimit, mirëmbajtjes dhe kalibrimit të etalonëve shtetërorë, si dhe përmes garantimit të përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare, në veçanti ISO/IEC 17025. Divizioni kontribuon në përmirësimin e infrastrukturës metrologjike kombëtare përmes ofrimit të shërbimeve profesionale të kalibrimit, organizimit të trajnimeve dhe pjesëmarrjes në rrjetet metrologjike evropiane dhe ndërkombëtare.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të Madhësive Elektrike dhe Termometrisë janë:

2.1.Përpilimi dhe plotësimi i formave për deklarimin e aftësive matëse dhe kalibruese, njohjen dhe përdorimin e gjurmueshmërisë të etalonëve shtetëror të matjes së madhësive elektrike, termometrisë dhe lagështisë relative të specifikuara për të cilat është përgjegjës divizioni;

2.2.Përgatitja dhe rishikimi i procedurave, instruksioneve dhe dokumenteve të nevojshme të divizionit;

2.3.Përpilimi dhe plotësimi i kërkesave për përgatitjen dhe kalibrimin e etalonëve referent të përdorura në rangun e specifikuar të matjeve në Republikën e Kosovës;

2.4.Sigurimi i një procesi efektiv të gjurmueshmërisë, sistemit të planifikimit, zhvillimit dhe ruajtjes së etalonëve shtetëror të matjes së madhësive të specifikuara fizike, si dhe transmetimin e vlerave të tyre, deri në etalonët e nivelit më të ulët ose të shprehura në formë të rezultateve të

matjes, në certifikatë kalibruese;

2.5.Zhvillimi dhe e mirëmbajtja e sistemit te menaxhimit të cilësisë të laboratorëve kalibrues në divizionin e madhësive elektrike, termometrisë dhe lagështisë relative në përputhje me kërkesat e standardit ISO/IEC 17025 dhe rekomandimet e specialistit të menaxhimit të sistemit të cilësisë;

2.6.Lëshimi i certifikatave të kalibrimit për mjetet matëse nga divizioni i lartë cekur sipas hierarkisë së gjurmueshmërisë dhe kërkesave që dalin nga menaxhimi sistemit të cilësisë të AMK;

2.7 .Organizimi i trajnimeve të vazhdueshme për stafin e tij të laboratorëve të kalibrimit, kryesisht në metrologjinë shkencore dhe industriale, dhe në vlerësimin e metodave kalibruese të fushave të madhësive për të cilat divizioni është përgjegjës;

2.8.Organizimi i ndër-krahasime laboratorike me laboratorët vendor të fushave të ngjashme, për vlerësimin e procedurave kalibruese, sipas kërkesave themelore nga sistemi i cilësisë së AMK;

2.9.Pjesëmarrja në aktivitetet përkatëse të Komiteteve Teknike EURAMET, duke përfshirë krahasimet ndër-laboratorike bilaterale dhe multilaterale në këtë divizion.

3. Udhëheqësi i Divizionit të Madhësive Elektrike dhe Termometrisë raporton tek Drejtori i Departamentit të Metrologjisë Shkencore dhe Industriale.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin e Madhësive Elektrike dhe Termometrisë është pesë (5).

Neni 13
Departamenti i Metrologjisë Ligjore

1. Departamenti i Metrologjisë Ligjore ka për qëllim të sigurojë zbatimin e kontrollit ligjor metrologjik dhe të garantojë gjurmueshmërinë e mjeteve matëse në fushën e madhësive mekanike, elektrike ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet ndërkombëtare. Departamenti kontribuon në mbrojtjen dhe të drejtën e konsumatorit përmes kontrollit të saktë të instrumenteve matëse, zhvillimit të metodave të reja, mirëmbajtjes së pajisjeve laboratorike dhe përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të cilësisë sipas standardeve ndërkombëtare.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit të Metrologjisë Ligjore janë:

2.1. Zbatimi i akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e metrologjisë ligjore;

2.2. Sigurimi i kontrollit ligjor metrologjik të mjeteve matëse në fushën e madhësive mekanike dhe elektrike, me qëllim të përmbushjes së kërkesave metrologjike, në përputhje me Rregulloren për kontrollin ligjor të instrumenteve matëse;

2.3.Zhvillimi i metodave dhe procedurave për kontrollin ligjor të instrumenteve matëse që përdoren në fushat e specifikuara të matjes;

2.4.Kryerja e kontrollit ligjor të mjeteve matëse në përdorim, me qëllim të përmbushjes së kërkesave metrologjike;

2.5. Zbatimi i strategjive zhvillimore për metrologjinë ligjore dhe përpilimi i analizave lidhur me cilësinë në këtë fushë;

2.6. Zhvillimi i aktiviteteve për ekspertizën metrologjike;
2.7. Propozimi i prioriteteve për projektet zhvillimore dhe ofrimi i mbështetjes për projektet që kanë të bëjnë me krahasimet laboratorike vendore;
2.8. Sigurimi i zbatimit të sistemit të cilësisë në përputhje me kërkesat e standardit ISO/IEC 17020 për aktivitetet inspektuese, në bashkëpunim me Zyrtarin e Lartë të Menaxhimit të Sistemit të Cilësisë.

3.Drejtori i Departamentit të Metrologjisë Ligjore raporton tek Drejtori Ekzekutiv i AMK.

4. Numri i punësuarve në Departamentin e Metrologjisë Ligjore është njëzet (20).

Neni 14
Divizioni i Madhësive Mekanike

1.Divizioni i madhësive mekanike ka për qëllim zhvillimin dhe sigurimin e kontrollit ligjor të mjeteve matëse në fushën e madhësive mekanike si dhe përcjelljen dhe mbajtjen e gjurmueshmërisë së etalonëve të punës deri te etaloni shtetërorë të matjes.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të Madhësive Mekanike janë:
2.1. Sigurimi i kontrollit ligjor metrologjik të mjeteve matëse në fushën e madhësive mekanike, në përputhje me Rregulloren për kontrollin ligjor të instrumenteve matëse;
2.2.Përcjellja dhe mirëmbajtja e gjurmueshmërisë së etalonëve të punës deri te etalonët shtetërorë të matjes;
2.3.Mirëmbajtja e pajisjeve në laboratorët e AMK që përdoren për kontrollin ligjor të instrumenteve matëse, me qëllim të sigurimit të shërbimeve cilësore për klientët e metrologjisë ligjore;
2.4. Mbështetja laboratorëve të caktuar dhe të emëruar nga AMK, të cilët marrin pjesë në kontrollin ligjor të instrumenteve matëse, për zhvillimin efektiv të metodave dhe procedurave të verifikimit, si dhe për ngritjen e kapaciteteve profesionale të stafit të tyre;
2.5. Sigurimi i zbatimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të menaxhimit të cilësisë në laboratorët e madhësive mekanike, në fushën e menaxhimit metrologjik, në përputhje me kërkesat e standardit ISO/IEC 17020 dhe rekomandimet e Zyrtarit të Lartë të Sistemit të Cilësisë.

3. Udhëheqësi i Divizionit të Madhësive Mekanike raporton tek Drejtori i Departamentit të Metrologjisë Ligjore.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin e Madhësive Mekanike është dymbëdhjetë (12).

Neni 15
Divizioni i Madhësive Elektrike

1. Divizioni i Madhësive elektrike ka për qëllim zhvillimin dhe sigurimin e kontrollit ligjor të mjeteve matëse në fushën e madhësive elektrike si dhe përcjelljen dhe mbajtjen e gjurmueshmërisë së etalonëve të punës deri te etalonët shtetërorë të matjes.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të Madhësive Elektrike janë:

2.1. Sigurimi i kontrollit ligjor metrologjik të instrumenteve matëse në fushën e madhësive elektrike, në përputhje me Rregulloren për kontrollin ligjor të instrumenteve matëse;

2.2. Përcjellja dhe mirëmbajtja e gjurmueshmërisë së indikacioneve të kontrolluara të instrumenteve matëse deri te etalonët shtetërorë të matjes;

2.3. Mirëmbajtja e pajisjeve në laboratorët e AMK që përdoren për kontrollin ligjor të instrumenteve matëse, me qëllim të sigurimit të shërbimeve cilësore për klientët e metrologjisë ligjore;

2.4. Mbështetja e laboratorëve të caktuar dhe të emëruar nga AMK, të cilët marrin pjesë në kontrollin ligjor të instrumenteve matëse, për zhvillimin efektiv të metodave dhe procedurave të verifikimit, si dhe për ngritjen e kapaciteteve profesionale të stafit të tyre;

2.5. Sigurimi i zbatimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të menaxhimit të cilësisë në laboratorët e madhësive elektrike dhe në fushën e menaxhimit metrologjik, në përputhje me kërkesat e standardit ISO/IEC 17020 dhe rekomandimet e Zyrtarit të lartë të Sistemit të Cilësisë.

3. Udhëheqësi i Divizionit të Madhësive Elektrike raporton tek Drejtori i Departamentit të Metrologjisë Ligjore.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin e Madhësive Elektrike është shtatë (7).

Neni 16
Departamenti i Punimeve nga Metalet e Çmuara

1.Departamenti i Punimeve nga Metalet e Çmuara ka për qëllim të garantojë kontrollin, analizën dhe gjurmueshmërinë e metaleve të çmuara në përputhje me kornizën ligjore dhe standardet profesionale, me qëllim të mbrojtjes së konsumatorit dhe sigurimit të cilësisë së produkteve prej metaleve të çmuara në treg. Departamenti angazhohet në realizimin e analizave kimike, ekspertizës teknike, kontrollit të pajisjeve matëse dhe zhvillimit të procedurave të reja për përmirësimin e infrastrukturës laboratorike dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale në këtë fushë.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit të Punimeve nga Metalet e Çmuara janë:

2.1.Propozimi i masave konkrete për zhvillimin dhe avancimin e laboratorëve të metaleve të çmuara në vend;

2.2. Realizimi i analizave kimike, kontrollimi dhe vulosja e metaleve të çmuara;

2.3.Realizimi i ekspertizës se punimeve prej metaleve të çmuara, të parashtruara nga organet publike;
2.4.Kontrollimi i mjeteve matëse që përdoren për matjet fiziko-kimike në laboratorët e metaleve të çmuara të AMK;
2.5. Zbatimi i akteve nënligjore për metalet e çmuara;
2.6.Zhvillimi i metodave dhe procedurave për kontrollin ligjor të metaleve të çmuara;
2.7.Përcjellja dhe mbajtja gjurmueshmërisë se materialeve referente dhe pajisjeve që përdoren në laboratorët e metaleve të çmuara;
2.8. Propozimi i prioriteteve dhe projekteve zhvillimore dhe ofrimi i pjesëmarrjes për projektet që kanë të bëjnë me krahasimet laboratorike për arritjen e kompetencës në fushën e metaleve të çmuara.

3. Udhëheqësi i Departamentit të Punimeve nga Metalet e Çmuara raporton tek Drejtori Ekzekutiv i AMK.

4. Numri i punësuarve në Departamentin e Punimeve nga Metalet e Çmuara është shtatë (7).

Neni 17
Divizioni për Kontrollim të Cilësisë së Arit dhe Platinës

1. Divizioni për Kontrollimin e Cilësisë së Arit dhe Platinës ka për qëllim të garantojë kontrollin dhe analizën e arit dhe platinës në përputhje me kornizën ligjore dhe standardet profesionale, me qëllim të mbrojtjes së konsumatorit dhe sigurimit të cilësisë së produkteve prej arit dhe platinës në treg.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Kontrollimin e Cilësisë së Arit dhe Platinës janë:
2.1. Realizimi i analizave kimike, kontrollimi dhe vulosja e arit dhe platinës;
2.2. Realizimi i ekspertizës së arit dhe platinës, të parashtruara nga organet publike;
2.3.Kontrollimi i mjeteve matëse që përdoren për matjet fiziko-kimike në laboratorët për kontrollimin e cilësisë së arti dhe platinës të AMK;
2.4. Zbatimi i akteve nënligjore për ari dhe platinë;
2.5. Zhvillimi i metodave dhe procedurave për kontrollin ligjor të arti dhe platinës;
2.6.Përcjellja dhe mbajtja gjurmueshmërisë se materialeve referente dhe pajisjeve që përdoren në laboratorët për kontrollimin e cilësisë së arti dhe platinës;
2.7.Propozimi i prioriteteve dhe projekteve zhvillimore dhe ofrimi i pjesëmarrjes për projektet që kanë të bëjnë me krahasimet laboratorike për arritjen e kompetencës në këtë fushë.

3. Udhëheqësi i Divizionit të Punimeve nga Metalet e Çmuara raporton tek Drejtori i Departamentit të Punimeve nga Metalet e Çmuara.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Kontrollimin e Arit dhe Platinës është tre (3).

Neni 18
Divizioni për kontrollim të cilësisë së Argjendit dhe Palladiumit

1. Divizioni për Kontrollim të Cilësisë së Argjendit dhe Palladiumit ka për qëllim të garantojë kontrollin dhe analizën e argjendit dhe palladiumit në përputhje me kornizën ligjore dhe standardet profesionale, me qëllim të mbrojtjes së konsumatorit dhe sigurimit të cilësisë së produkteve prej argjendit dhe palladiumit në treg.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Kontrollim të Cilësisë së Argjendit dhe Palladiumit janë:

2.1.Realizimi i analizave kimike, kontrollimi dhe vulosja e argjenditi dhe palladiumit;

2.2. Realizimi i ekspertizës se argjendit dhe palladiumit, të parashtruara nga organet publike;

2.3.Kontrollimi i mjeteve matëse që përdoren për matjet fiziko-kimike në laboratorët e argjendit dhe palladiumit të AMK;

2.4. Zbatimi i akteve nënligjore për argjend dhe palladium;

2.5. Zhvillimi i metodave dhe procedurave për kontrollin ligjor të argjendit dhe palladiumit;

2.6.Përcjellja dhe mbajtja gjurmueshmërisë së materialeve referente dhe pajisjeve që përdoren në laboratorët e argjendit dhe palladiumi;

2.7.Propozimi i prioriteteve dhe projekteve zhvillimore dhe ofrimi i pjesëmarrjes për projektet që kanë të bëjnë me krahasimet laboratorike për arritjen e kompetencës në këtë fushë.

3. Udhëheqësi i Divizionit për Kontrollim të Cilësisë së Argjendit dhe Palladiumit raporton tek Drejtori i Departamentit të punimeve nga metalet e çmuara.

4. Numri i të punësuarve në divizionin për kontrollim të cilësisë së argjendit dhe palladiumit është tre (3).

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE SHFUQIZUESE

Neni 19
Dispozita kalimtare

1. Rritja apo zvogëlimi i numrit të personelit në pajtim me ligjin vjetor të buxhetit nuk krijon nevojë për plotësim ndryshimin e kësaj Rregulloreje, përpos në rastet kur krijohen dhe/apo shuhen strukturat organizative.

2. Ndryshimi i vendeve të punës të sistematizuara, krijimi ose shuarja e vendeve të punës dhe ndryshimi i klasifikimit të tyre bëhen në pajtim me legjislacionin për buxhetin, legjislacionin për zyrtarët publik dhe procedurën e ndryshimit të rregullores për organizimin e brendshëm.

Neni 20
Shërbimet e Përgjithshme

Për kryerjen e shërbimeve të përgjithshme siç janë: Auditimi, Logjistika, Ligjorja, Prokurimi, Financat, Komunikimi, Certifikimi dhe Burimet Njerëzore për Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës obligohet Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë Tregtisë dhe Inovacionit sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 21
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja (ZKM) Nr. 09/2023 Për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Agjencisë së Metrologjisë së Kosovës.

Neni 22
Shtojca

Emërtimi i pozitave të vendeve të punës të zyrtarëve dhe struktura organizative e AMK përcaktohen sipas shtojcave të cilat janë pjesë përbërëse të kësaj Rregulloreje.

Neni 23
Hyrja në Fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

_____

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Më datë: 27 tetor 2026

Shtojca 1	Vendet e punës së Agjencisë së Metrologjisë së Kosovës (AMK)

Pozicioni/Struktura	Klasa	Grupi (i përgjithshëm ose i veçantë)	Numri	Totali
1. Zyra e Drejtorit Ekzekutiv				
Drejtori Ekzekutiv	Drejtues i Lartë		1	1
Asistent administrativ	Profesional 3	Grupi administrativ i përgjithshëm	1	3
Zyrtar i lartë i Sistemit të Cilësisë	Specialist	Grupi i përgjithshëm i inxhinierisë	1	
Zyrtar i bazës së të dhënave	Profesional 2	Grupi i teknologjisë se te dhënave	1	
Departamenti i Metrologjisë Shkencore dhe Industriale				
Drejtori i Departamentit të Metrologjisë Shkencore dhe Industriale	Drejtues i Mesëm		**1**	1
Divizioni i Masës dhe Matjeve Dimensionale				
Udhëheqësi i Divizionit për Masë dhe Matje Dimensionale	Drejtues i ulet		1	4
Zyrtar i lartë i metrologjisë për masë Zyrtar i lartë i metrologjisë për gjatësi dhe matje dimensionale	Specialist Specialist	Grupi i përgjithshëm i inxhinierisë Grupi i përgjithshëm i inxhinierisë	2 1	
Divizioni i Forcës dhe Presionit				
Udhëheqësi i Divizionit për Forcë dhe Presion	Drejtues i ulët		1	**4**
Zyrtar i lartë i metrologjisë për forcë Zyrtar i lartë i metrologjisë për presion	Specialist	Grupi i inxhinierisë mekanike Grupi i inxhinierisë mekanike	2 1	

Divizioni i Vëllimit dhe Rrjedhjes				
Udhëheqësi i Divizionit për Vëllim dhe Rrjedhje	Drejtues i ulët		**1**	4
Zyrtar i lartë i metrologjisë për vëllim Zyrtar i lartë i metrologjisë për rrjedhje	Specialist Specialist	Grupi i inxhinierisë mekanike Grupi i inxhinierisë mekanike	**2** **1**	
Divizioni i Madhësive Elektrike dhe Termometrisë				
Udhëheqësi i Divizionit për Madhësi Elektrike dhe Termometri	Drejtues i ulët		**1**	5
Zyrtar i lartë i metrologjisë për madhësi elektrike	Specialist	Grupi i inxhinierisë elektrike	**2**	
Zyrtar i lartë i metrologjisë për kohë dhe frekuencë	Specialist	Grupi i inxhinierisë elektrike	**1**	
Zyrtar i lartë i metrologjisë për temperaturë dhe lagështi relative	Specialist	Grupi i përgjithshëm i inxhinierisë	**1**	
Departamenti i Metrologjisë Ligjore				
Drejtor i Departamentit të Metrologjisë Ligjore	Drejtues i Mesëm		1	1
Divizioni i madhësive mekanike				
Udhëheqësi i Divizionit për Madhësi mekanike	Drejtues i ulët		**1**	12
Zyrtar i lartë i metrologjisë për masë Zyrtar i lartë i metrologjisë për vëllim dhe rrjedhje Zyrtar i lartë për para paketime dhe shishe si enë matëse	Specialist Specialist Specialist	Grupi i përgjithshëm i inxhinierisë Grupi i inxhinierisë mekanike Grupi i Fizikës	**3** **5** **3**	
Divizionit i madhësive elektrike				
Udhëheqësi i Divizionit për madhësi elektrike	Drejtues i ulët		**1**	

Zyrtar i lartë i metrologjisë për madhësi elektrike Zyrtar i lartë metrologjisë për kohë dhe frekuencë	Specialist Specialist	Grupi i inxhinierisë elektrike Grupi i inxhinierisë elektrike	**4** **2**	7
Departamenti i Punimeve nga Metalet e Çmuara				
Drejtor i Departamentit për Punimet nga Metalet e Çmuara	Drejtues i mesëm		**1**	1
Divizioni për kontrollim të cilësisë së Arit dhe Platinës				
Udhëheqës i Divizionit për kontrollim të cilësisë së Arit dhe Platinës	Drejtues i ulët		**1**	3
Zyrtar i lartë për kontrollin e cilësisë Arit dhe Platinës	Specialist	Grupi i Kimisë	**2**	
Divizioni për kontrollim të cilësisë së Argjendit dhe Palladiumit				3
Udhëheqës i Divizionit për kontrollim të cilësisë së Argjendit dhe Palladiumit	Drejtues i ulët		**1**	
Zyrtar i lartë për kontrollim e cilësisë së Argjendit dhe palladiumit	Specialist	Grupi i Kimisë	**2**	
			Totali	**49**

Shtojca 2

Agjencia e Metrologjisë e Kosovës (AMK)

Organogrami

